



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 03.06.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 31.05.2021 të parashtruar nga Operatorit Ekonomik “PE-VLA-KU” sh.p.k.- Dega në Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i Qarkores – Tranziti i ri”, me Nr. të Prok: 632-19-2998-5-1-1 nxjerr:

### V E N D I M

1. **Refuzohet si** e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik “PE-VLA-KU” sh.p.k.- Dega në Kosovë, e dt. 31.05.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Qarkores – Tranziti i ri”, me Nr. të Prok: 632-19-2998-5-1-1, kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK –së, të datës 16.03.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .

2. Vërtetohet **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** të publikuar me datë: 16.03.2021;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

### A r s y e t i m

Operatori Ekonomik “PE-VLA-KU” sh.p.k.- Dega në Kosovë, me datë 31.05.2021, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i Qarkores – Tranziti i ri”, me Nr. të Prok: 632-19-2998-5-1-1,

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 06.03.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Bazuar në nenin 116, paragrafi 6 ,nenin dhe 117 paragrafi 1, të Ligjit për Prokurimin Publik N.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092, si dhe në faktin se OSHP nuk ka asnjë informacion se kur do të emërohet Bordi nga institucionet kompetente dhe sa do të zgjasin procedurat e përzgjedhjes, Autoriteti Kontraktues, Komuna e Gjakovës, ka qenë e obliguar për arsye të afateve ligjore që të vazhdoj me dhënien e kontratës dhe lidhjen e saj .

Autoriteti Kontraktues pas rishikimit të dokumenteve, dhe duke u mbështetur në nenin 1 të LPP-së, qëllimi i të cilit është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të Autoriteteve Kontraktuese në Kosovë, dhe të nenit 6 të këtij ligji sipas të cilit Autoritetet Kontraktuese janë të obliguara që të sigurojë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrë më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, konstaton se Grupi i Operatorve Ekonomik **Sh "Drini Company" sh.p.k.** i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara në dosjen e tenderit dhe Autoriteti Kontraktues, mbetet pranë vendimit të marrë.

Sa u përket pretendimeve ndaj Operatorëve tjerë Ekonomik si: "Euroasphalt"sh.p.k. & "Trasing Group"shpk, dhe "Mirusha Company"sh.p.k. & "Lika Trade" shpk & "Infra Plus"shpk, keta Operatorë Ekonomik jane eliminuar sepse kanë qenë administrativisht të papërgjegjshëm.

Tenderi juaj është i pasuksesshëm për arsye se nuk i plotëson kerkesat e Autoritetit Kontraktues, sepse tenderi juaj është me çmim më të lartë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

  
**Faton Gutaj**  
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;  
Arkivit të Komunës